



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:182229

Datë: 11.03.2025

Numri i dokumentit: 06974734

P.nr.149/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit G.B nga fshati ..., Komuna Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Shyqyri Sylja, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.I.nr.341/2022 të datës 20.02.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 11.03.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit Shaqir Sedolli, të pandehurit G.B dhe mbrojtësit av. Shyqyri Sylja, në të njëjtën datë shpalli, dhe me datë 11.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: G.B, nga i ati E..., e ëma F..., mbiemri i vajzërisë H..., i lindur me datën ..., me vendbanim në fshatin ..., komuna Mitrovicë, i martuar, babai një fëmije, zdrukthëtar- i vetëpunësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLET FAJTOR

I. SEPSE: Nga data dhe viti i pacaktuar e deri me datë 29.08.2022 rreth orës 22:05, në Vushtrri në rrugën "...", saktësisht në kafiterinë "...", i pandehuri G.B ka mbajtur në posedim pa leje

përkatëse e në kundërshtim me ligjin për armët, armën e zjarrit të markës “MCD”, prodhim izraelit, me numër serik 10047, kalibri 9 mm, karikator i armës përkatëse dhe 15 fishek, të njëjtat janë sekuestruar nga zyrtarët policor,

Me këtë ka kryer veprën penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-se (Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074).

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 269, 276 dhe 364 të KPPK-së, të akuzuarin,

E G J Y K O N

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 1,500€ (njëmijë e pesëqind euro), i cili dënim duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri refuzon të paguaj dënimin me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo pesëmbëdhjetë (15) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim..

II. Konfiskohet arma e zjarrit e markës “MCD”, prodhim izraelit, me numër serik 10047, kalibri 9 mm, karikator i armës përkatëse dhe 15 fishek.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.341/2022 të datës 20.02.2023, kundër të pandehurit G.B nga fshati ..., Komuna Mitrovicë, për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Shaqir Sedolli, i pandehuri G.B së bashku me mbrojtësin av. Shyqyri Sylja.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe sqarimit të benefiteve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjti i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri G.B është deklaruar fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, është penduar për veprën, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale të ngjashme apo vepra tjera penale.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë dhe se deklarimi mbi pranimin e fajësisë është në përputhje dispozitat e KPPRK-së për institutin e pranimit të fajësisë, i njëjti mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, është bërë në mënyrë vullnetare dhe i pandehuri i kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, andaj nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë dhe gjykatës i ka propozuar që pranimin e fajësisë ta aprovojë. Andaj, nëse gjykata e aprovon pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit, përcaktimit të llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ashtu që si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr parasysh faktin se i njëjti përveç që ka pasur në pronësi armën pa leje, i njëjti e ka bartur me vete në kafiteri, ku pritet që të ketë edhe presona tjerë, po ashtu ka pasur me vete edhe 15 fishekë, e po ashtu prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale dhe nëse nga ajo rezulton se i pandehuri është i dënuar edhe më parë ta merr si rrethanë rënduese dhe e kundërta nëse nuk është dënuar më parë, ta merr parasysh se rrethanë lehtësuese.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i mbrojturi i tij ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzën e prokurorit të shtetit, pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnetin e tij të lirë, pa ndikim, joshje apo premtim, e pas konsultimeve të mjaftueshme me të si mbrojtës, ndërsa pranimi i fajësisë gjenë mbështetje edhe në provat që i janë bashkëngjitur aktakuzës. Andaj i ka propozuar gjykatës që të bëjë

miratimin e pranimit të fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij dhe me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh një mori rrethanat lehtësuese sikurse që janë: është i moshës së re, i martuar, baba i një fëmije, më parë i pa gjykuar, ndaj tij nuk zbatohet procedurë për ndonjë veprë tjetër penale, pendimin e tij të thellë, premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, pastaj është pronar i biznesit "...", që është biznes për prodhimin e mobileve, e po ashtu si rrethanë lehtësuese ta merr edhe pranimin e fajësisë me çka e ka ndihmuar gjykatën në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, e ne kuadër të këtyre rrethanave lehtësuese e në mungesë të rrethanave posaçërisht rënduese, të pandehurit ti shqiptojë një dënim me gjobë, meqenëse është në gjendje ta paguajë, dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Kallëzimi penal 2022-BD-818 i datës 30.08.2022, Raporti policor i datës 29.08.2022, Procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit, i datës 29.08.2022, Vërtetimi mbi armën e konfiskuar i datës 29.08.2022, Fotodokumentacioni i datës 29.08.2022, e kaluara kriminale dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, ligjvënësi ka pavarur mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7,500) euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuarit për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, vendosi që të shqiptojë dënim me gjobë në shumë prej një mijë e pesëqind (1500) euro, të cilin dënim është obliguar i pandehuri që ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese për të pandehurin ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale, ndërsa në kuadër të rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, më parë i pa gjykuar, ashtu që ndaj të njëjtit shqiptohet një dënim sa më i butë.

Gjykata erdhi në përfundim se lartësia e dënimit me gjobë prej 1500 (njëmijë e pesëqind euro), i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, është dënim në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së,

Vendimin lidhur me konfiskimin e armës, gjykata e ka marr në bazë të nenit 269 par.1 KPPK-së e në lidhje me nenin 276 KPPRK-së, pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari nuk posedonte leje për armëmbajtje.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.149/2023, datë 11.03.2025

Numri i lëndës: 2022:182229
Datë: 11.03.2025
Numri i dokumentit: 06974734

Zyrtarja Ligjore
Arta Jusufi

Gj y q t a r i
Naim Rekalio

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.